



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDYSHE

THIRRJE PËR APLIKIM

TRAJNIMI PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE PËR UDHËRRËFYESIT TURISTIK (CICERONËVE) NË JANJEVË

OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Hartëzimi i Turizmit Rural në Janjevë”, ka për qëllim të ndihmoj në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes dokumentimit, promovimit si dhe përmes transferimit të njohurive dhe shkathtësive tek të rinjtë e Janjevës. Në kuadër të projektit jemi duke organizuar **“Trajnimin për Zhvillimin e Aftësive për Udhërrëfyesit Turistik (Ciceronëve) në Janjevë”** dhe përmes kësaj thirrje publike i ftojmë të gjithë të interesuarit/at të aplikojnë për të marrë pjesë në trajnim, ku do të keni mundësi të mësoni për rolin e udhërrëfyesve turistik/ciceronëve dhe si ndikon promovimi i turizmit në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Të drejtë aplikimi kanë personat e moshës 20 deri 45 vjeç nga të gjitha komunitetet që banojnë në rajonin e Janjevës (Shqiptar, Kroat, Romë, Ashkali, Egjiptas, Turk, Boshnjak). Për këtë punëtori do të përzgjidhen 20 pjesëmarrës/e sipas kriterëve të cekura më poshtë. Punëtorja do të zgjasë 7 (shtatë) ditë (përgjatë fundjavave) dhe pjesëmarrësit/et do të kenë mundësinë të njoftohen me praktikat themelore të prezantimit dhe promovimit turistik të pasurive kulturore dhe natyrore të vendit si dhe do të pajisen me njohuritë dhe shkathtësitë themelore të udhërrëfyesve turistik (ciceronëve). Pjesëmarrësit/et e përzgjedhur/a obligohen që të përcjellin rregullisht punëtorinë dhe zotohen që të angazhohen dhe përkushtohen ndaj veprimtarisë duke krijuar marrëdhënie të mira me grupin dhe stafin e punëtorisë.

Programi i punëtorisë do të trajtojë disa tema, si:

- Konceptet dhe llojet e guidave turistike;
- Sjellja profesionale dhe etika e guidave turistike;
- Itinerari/shtegu turistik;
- Praktikat e mira në terren si guida turistike;
- Mundësitë e punësimit përmes turizmit/biznesi turistik

Pas përfundimit të programit të punëtorisë, pjesëmarrësit/et do të fitojnë njohuri të përgjithshme se çka duhet për të udhëhequr ture turistike të rajonit dhe çka duhet të kenë parasysh për përgatitjen e ofertave turistike si dhe si të ofrojnë një përvojë të shkëlqyeshme për turistët.

Gjithashtu deri në 5 (pesë) pjesëmarrës/e më të suksesshëm/shme do të kenë mundësinë të jenë pjesë e ekipës së hulumtimit në terren (me pagesë) për identifikimin e aseteve turistike të Janjevës dhe do të barten në platformën/webfaqen e cila do të publikohet në kuadër të projektit.

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Rr. Xhemajl Mustafa, 9/1, LL-4, Nr. 7, Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

Kualifikimet e aplikantëve/të interesuarve:

- Të jetë banor/e i/e fshatit të Janjevës;
- Nivel i mirë i njohurive të njërës nga gjuhët lokale në të folur dhe shkruar (gjuhë shqipe dhe serbe/kroate). Njohuria në gjuhën angleze është përparësi (njohja e ndonjë gjuhe tjetër nuk kërkohet por do të vlerësohet);
- Kërkohet disponueshmëri për pjesëmarrje dhe angazhim në orarin e plotë në programin e punëtorisë.

Mënyra e aplikimit: Aplikimi mund të bëhet duke plotësuar formën online që gjendet në webfaqen e organizatës www.ecmandryshe.org, brenda linkut Konkurse dhe/apo nëpërmjet linkut: <https://forms.gle/4C9Sehc5yb9FrMZm6>. Për më shumë informata mund të na kontaktoni në: 049 714 024 & 029 222 771.

Afati i aplikimit: Afati i fundit për aplikim është data 24 Mars 2023, ora 00:00. Vetëm pjesëmarrësit/et e përzgjedhur/a do të njoftohen/lajmërohen brenda 5 (pesë) ditëve pas mbylljes së thirrjes. Në rast të mospranimit të kandidatëve të përshtatshëm, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën e anulimit të kësaj thirrje.

*Projekti “Hartëzimi i Turizmit Rural në Janjevë” i OJQ-së EC Ma Ndryshe është pjesë e grantit të financuar nga projekti “Trashëgimia Kulturore si Nxitëse e Ringjalljes Ekonomike të Janjevës” që financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe zbatohet nga **Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.***